



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
OPSTINA SUVA REKA / MUNICIPALITY OF SUHAREKE
ZYRA E PROKURIMIT
PROCUREMENT OFFICE

Nr: 012 /2022

Nr. Protokoli: 30/2022

Date: 27.06.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës: **25.06.2022**, të parashtruar nga Operoret Ekonomik: **GASHI ING SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë** me Nr. të Prokurimi: **624-22-5350-5-1-1 & 624-22-053-511**, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës **25.06.2022**, e parashtruar nga Operoret Ekonomik: **GASHI ING SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugën Skenderbeu - Suharekë** me Nr. të Prokurimi: **624-22-5350-5-1-1 & 624-22-053-511**, kundër Njoftim për Kontratë e AK –së, të datës **03.06.2002** të publikuar në platformën elektronike.
2. Vërtetohet NJOFTIMI PER KONTRATË I AK i publikuar me datë: 03.06.2022 dhe ndryshimi i bere me date: 08.06.2022 (B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara).
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 25.06.2022, ka pranuar kërkesa për rishqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Ndërtimi dhe rregullimi Kolektorit në rrugen Skenderbeu - Suharekë**, kundër Njoftim per Kontratë të AK –së, të dates, **03.06.2022** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi ka pranuar kërkesën për rishqyrtim, ka analizuar pretendimet e OE, dhe ka ardhur në përfundim se:

- Kërkesa që në rast grupi të OE lideri të përmbushë këtë kriter në 60% të vlerës së kërkuar, është konform LPP-së dhe nenit 27.4 të RRUOPP-së.
- Edhe kërkesa e kapacitetit teknik dhe professional për referenca, është në harmoni me LPP-në, duke kërkuar që projektet të jenë në vlerë prej së paku 1.5X vlera e parashikuar e kontratës, I cili kriter është respektuar nga ne si AK.
- Po ashtu kërkesa tjetër e kapacitetit teknik dhe profesional-pajisjet, ku OE ka kërkuar që të zvoglohet numri i kamionëve nga 5 në 4, për AK është kërkesë pa kurfarë baze ligjore sepse për një project të tillë është kërkuar një **minimum** prej 5 kamioneve të rëndë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Shef i Zyrës së Prokurimit
Bujar Kuçi

